



Datë: 29.05.2025

Numër Protokolli: 3975/2025

A.nr.536/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Arditë Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.536/2025, të datës 24.03.2025, të parashtruar nga ankuesja S.S-M, kundër organit të punësimit: Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike “*vlerësim i rezultateve të punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2, 1.4 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 29.05.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.536/2025, e datës 24.03.2025, e parashtruar nga ankuesja S.S-M, në atë mënyrë që **anulohet** Formuari i datës 21.02.2025, lidhur më vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesen për vitin 2024.

II. Obligohet Drejtori i Njësisë për Inspektim Gjyqësor i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi të bëjë vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesen për vitin 2024.

III. Obligohen Drejtori i Përgjithshëm dhe Udhëheqësi i Njësisë së Burimeve Njerëzore të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, që të ndërmarrin çdo veprim administrativ në kuptim të zbatimit të këtij vendimi sikurse është përcaktuar në pikën II të këtij dispozitivi.

IV .Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile, S.S-M (*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja*) e punësuar në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me datë 24.03.2025, ka parashtruar ankesë të regjistruar nën shenjen A.nr.536/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vlerësimit të rezultateve të punës të datës 21.02.2024, gjegjësisht kundër kompetencës së vlerësimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ndërsa me datë 08.05.2025 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit, pas pranimit të kërkesës së kryetares së Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjes së Ankesave, me Vendimin me numër VK/2025 dhe numër të protokollit 3071/2025 të datës 07.05.2025, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës së parashtruar nga ankuesja edhe për dhjetë (10) ditë pune

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave(në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit), **vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritore administroi këto prova:** Ankesën me numër protokolli 1945/2025 e datës 24.03.2025 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Dokument identifikimi i ankueses; E-maili i datës 21.03.2025; Formulari për vlerësimin e rezultateve të punës i vitit 2024; Vendimin për pushim pa pages me numër Reference:DS-1407/2024, të datës 26.09.2024; E-mail i datës 09.12.2022; Parashtrësë e datës 24.04.2024, për plotësimin e ankesës; Akt emërimin e datës 17.05.2013; Formulari për vlerësimin e rezultateve të punës i datës 15.01.2017; Vlerësimi i punës i personelit përkrahës; E-mailin e datës 09.12.2022; Formulari i vlerësimit të rezultateve të punës i vitit 2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë; Përgjigjen në ankesë; Vendimin me numër Reference:DS-038/2025 të datës 29.01.2025; E-mailin e datës 03.04.2024; Vendimin me numër Reference:DS-180/2024 të datës 03.04.2024.

Kolegji i Këshillit, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, ka gjetur së ankesa **është e bazuar, sepse:**

Kolegji i Këshillit, nga analizimi i shkresave të lëndës konstaton se ankuesja sipas Akt emërimit te datës 17.05.2013, është punësuar në pozitën e punës *Shefe e Shërbimit të Përgjithshëm*, në Njësinë për Shqyrtimin e Performancës së Gjyqësorit në kuadër të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: SKGJK), ndërsa sipas Vendimit me numër Reference:DS-038/2025 të datës 29.01.2025, të Drejtorit të Përgjithshëm të SKGJK-së, e njëjta Transferuar/Sistemuar në pozitën Udhëheqëse e Zyrës për Menaxhimin e Kontratave.

Tutje, sipas shkresave të lëndës rezulton se Ushtruesja e Detyrës e Drejtorit të Zyrës për Disiplinim në Njësinë për Inspektim Gjyqësor, ka bërë vlerësimin e rezultateve në punës për ankuesen për vitin 2024, dhe atë me notën e përgjithshme: 3 apo *arrin pritshmëritë*.

Ankuesja, në ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundërshton kompetencën e vlerësueses së saj lidhur me vlerësimin e rezultateve në punë të datës 21.02.2025, ashtu që e njëjta propozon aprovimin e ankesës si të bazuar, me detyrimin që Drejtori i Njesisë për Inspektim Gjyqësor, ta vlerësoj të njëjtën sipas pozitës me akt emërimin dhe kompetencë të vlerësimit.

Kolegji i Këshillit në pikëpamje të kompetencës lëndore të Këshillit për vendosje lidhur me ketë çështje administrative, i'u referua nenit 6, paragrafi 4 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *4. Të punësuarat/it e administratës në kuadër të sistemit të drejtësisë, Gjykatës Kushtetuese, Presidencës, Kuvendit të Republikës së Kosovës, si dhe institucioneve të pavarura kushtetuese janë nëpunës civil me status të veçantë, rregullimi i të cilëve bëhet me akt të veçantë, kështu që, nisur nga ky referim ligjor rrjedhë së të punësuarit në administratë të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor kanë statusin e nëpunësit civilë më status të veçantë dhe së mbi ketë bazë ligjore Këshilli Gjyqësor me akt të veçantë ligjor ka rregulluar procedurën e rezultateve në punë për nëpunësit e administratës së sistemit gjyqësor, gjegjësisht me Rregulloren Nr.10/2024 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë për Nëpunësit në Administratën e Sistemit Gjyqësorë të Kosovës, ku sipas nenit 5, paragrafit 1 përcaktohet se : 1. Vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësin e punësuar në administratën e sistemit gjyqësor përbëhet prej procesit, si në vijim: 1.1. mbikëqyrjen e vazhdueshme të rezultateve të punës nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë; 1.2. vlerësimin vjetor të rezultateve të punës nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë.; dhe se bazuar në shkresat e lëndës ku konstatohet se, përmes Formularit të datës*

20.12.2023, për vlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2023, ankuesja ishte vlerësuar nga Drejtori i Njesisë për Inspektim Gjyqësor, edhe pse në fillim të të njëjtit vit apo më datë 10.01.2023 kishte hyrë në fuqi Rregullorja Nr.14/2022 për Organizimin dhe Funksonimin e Njesisë për Inspektim Gjyqësor, e cila nuk kishte paraparë pozitën e ankueses atë të Shefes së Shërbimit të Përgjithshëm, në Njesisë për Shqyrtimin e Performancës së Gjyqësorit, ashtu siç nuk e kishte paraparë apo ishte shuar edhe nga Rregullorja Nr.02/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës për Nëpunësit Civil në Administratën e Sistemit Gjyqësor, e miratuar më datë 06.06.2024, për të cilën çështje nga marrëdhënia e punës Këshilli kishte vendosur përmes Vendimit A.nr.1568/2024, ashtu që tani më ankuesja është transferuar/sistemuar në pozitën e punës Udhëheqëse e Zyrës për Menaxhimin e Kontratave pranë SKGJK-së.

Andaj, duke qenë se ankuesja për vitin 2023 ishte vlerësuar nga Drejtori i Njesisë për Inspektim Gjyqësor, edhe pse pozita e saj me aktin e organizimit dhe funksionimit të Njesisë për Inspektim Gjyqësor, nuk ishte paraparë apo ishte shuar, Kolegji i Këshillit, thekson faktin se Akt emërimi i ankueses i datës 17.05.2013, ka qenë në fuqi deri në nxjerrjen e Vendimit me numër Reference:DS-038/2025 të datës 29.01.2025, të Drejtorit të Përgjithshëm të SKGJK-së, ku e njëjta siç u theksua edhe më sipër është transferuar/sistemuar në pozitën Udhëheqëse e Zyrës për Menaxhimin e Kontratave, ndaj si rrjedhojë Kolegji i Këshillit, konstaton se pretendimet ankimore të ankueses janë të bazuara, dhe më qellim të kthimit të ligjshmërisë e në kuptim të dispozitave të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, 1.4 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, ashtu që të obligoj Drejtorin e Njesisë për Inspektim Gjyqësor të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, i cili në cilësi të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi të bëjë vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesen, për vitin 2024.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.536/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses, S.S-M;
- Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretarit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Drejtori të Njesisë për Inspektim Gjyqësor të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.